

Qendra e Këshillimit Ligjor

Advocacy and Legal Advice Centre - (ALAC), është një projekt i Transparency International Albania, i financuar nga Komisioni Europian. Krijimi i kësaj qendre ka ardhur nga nevoja për të përmirësuar nivelin e njohurive të qytetarëve mbi sfidat, me të cilat ballafaqohen në përballjen me korrupsionin e përditshëm, si edhe për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të tyre lidhur me mekanizmat ligjorë dhe autoritetet përgjegjëse për denoncimin e akteve korruptive.

Përmes shërbimeve që ofron, qendra ka si qëllim të adresojë në mënyrë parandaluese çështjet që rrjedhin nga aktet korruptive që ndodhin në një gamë të gjerë të segmenteve të sektorit publik, duke i ofruar viktimave dhe dëshmitarëve informacion lidhur me mënyrat e përgjithshme dhe ato specifike të ndërhyrjes për zgjidhjen e rastit konkret të prezantuar pranë saj.

MOS HEZITONI

TË NA KONTAKTONI !

Telefono !

042 267 457

Të gjithë ju, që keni nevojë për ndihmë jeni të mirëpritur në Qendrën e Këshillimit Ligjor çdo ditë nga ora **08:00 - 16:00**

Çdo aplikim duhet të mbështetet me dokumentet kryesore të cilat kanë lidhje me denoncimin e korrupsionit dhe/ose me çështjen për të cilën kërkohet asistencë.

Aplikimi mund të kryhet edhe online në adresën e postës elektronike:

leginet@albaniaonline.net

ADRESA

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 5 (blu)

Projekt 2000, Kati 2, Nr.6

Tel: **042 267 457**

E-mail: **leginet@albaniaonline.net**



**E DREJTA E
INFORMIMIT
MBI
DOKUMENTET
ZYRTARE**



Projekt i financuar nga KOMISIONI EUROPIAN

E DREJTA PËR INFORMIM

Nga 30 qershori 1999, me hyrjen në fuqi të Ligjit "Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet Zyrtare" (ligji për informimin), qytetarët kanë gëzuar të drejtën për të kërkuar informacion për dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione publike, pa qënë të detyruar të shpjegojnë motivet.

Ligji për informimin synon të promovojë kulturën e transparencës dhe përgjegjshmërisë së administratës publike, në mënyrë që qytetarët të kenë dijeni mbi mënyrën e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe shpenzimit të parave publike prej saj.

Institucioni që kujdeset për zbatimin e këtij ligji është Avokati i Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Pavarësisht se ligji për informimin prezumon detyrimin e administratës për dhënien e informacionit, ai njeh gjithashtu mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte në raste të caktuara.

Nëse qytetarët pësojnë një dëm për shkak të shkeljes së ligjit për informim, kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim.

TË DREJTAT E QYTETARËVE

Sipas ligjit, çdo qytetarë ka të drejtë:

- ⇒ të kërkojë informacion për "dokumentet zyrtare", që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet për të cilat e kërkon një informacion të tillë.
- ⇒ të kërkojë informacion për të dhënat vetjake (të mbajtura në një dokument zyrtar) të personave që kryejnë funksione shtetërore, për aq sa këto lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji për personat që i ushtrojnë këto detyra.
- ⇒ të njihet me dosjet dhe regjistrat e administratës (përveçse kur ndalohet shprehimisht nga ligji).

SI MUND TË KËRKOHET INFORMACIONI

Qytetarët mund ta kërkojnë informacionin duke paraqitur një kërkesë të thjeshtë me shkrim nëpërmjet postës apo dorazi, ose në mënyrë verbale pranë institucionit përgjegjës. Sipas ligjit informacioni jepet pa pagesë, përveç rastit kur kjo gjë ka shpenzime.

Administrata ka detyrimin për të dhënë përgjigje me shkrim ose kopje të dokumentave të kërkuara. Informacioni mund të jepet në ndonjë formë tjetër (psh: verbale), vetëm nëse për këtë merret pëlqimi me shkrim i kërkuarit.

AFATI PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT

Administrata është e detyruar të japë informacionin brenda 40 ditëve nga depozitimi i kërkesës. Nëse e ka të pamundur mund ta shtyje afatin deri në 10 ditë.

ANKIMI PËR MOSDHËNIEN E INFORMACIONIT

Ankimi administrativ mund të bëhet para:

- a) organit që i është drejtuar kërkesa ;
- b) organit epror të organit të përmendur më sipër ;
- c) Avokatit të Popullit ;
- ç) gjykatës.

KUFIZIMET

Çdo organ i administratës në nivel qendror apo lokal, si edhe entet publike, janë të detyruar të japin çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve :

- ♦ Kur informacioni i kërkuar cënon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të një personi tjetër.
- ♦ Rastet e dokumentave që me ligj klasifikohen si sekret shtetëror.

Në këto raste autoriteti shtetëror është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga depozitimi i kërkesës, të njoftojë me shkrim kërkuarin për arsyet dhe bazën ligjore që nuk lejojnë dhënien plote apo të pjesshme të informacionit.